
L I G J
Nr.7746, datë 28.7.1993
PËR HIDROKARBURET (KËRKIMI DHE PRODHIMI)
I NDRYSHUAR ME:
LIGJIN Nr.7853, datë 29.7.1994
LIGJIN Nr.8297 DATË 4.3.1998
LIGJIN Nr.10 137, datë 11.5.2009
AKTIN NORMATIV Nr.2, datë 16.6.2010
LIGJIN Nr. 31/2012
LIGJIN Nr. 19/2015

Meqenëse politika e Republikës së Shqipërisë ka për qëllim :

(I) të nxisë kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit natyror;

(II) të rehabilitojë pajisjet ekzistuese dhe të rrisë nxjerrjen e naftës dhe gazit nga rezervat tashmë të zbuluara ;

(III) të sigurojë që zhvillimi i këtyre rezervave të pakthyeshme të bëhet në përputhje me interesat kombëtare, në mënyrë të rregullt, në përputhje me standardet e aplikueshme ndërkombëtare;

(IV) të sigurojë që operacionet e hidrokarbureve nuk rrezikojnë jetën njerëzore apo i shkaktojnë dëme mjedisit, në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni I

Citimi

Ky ligj citohet Ligji për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), 1993.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj vetëm përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, "Albpetrol" është një shoqëri tregtare, që zotëron të drejta kërkimi, prodhimi dhe tregtimi të naftës e gazit në Shqipëri."

"Gaz natyror" do të thotë gjithë hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë në kushte atmosferike normale duke përfshirë gazin e lëngët, gazin e thatë, gazin në hapësirën unazore dhe gazin mbetës që mbetet pas nxjerrjes apo ndarjes së hidrokarbureve të lëngëta nga gazi i lëngët dhe gazi jo hidrokarbur i prodhuar së bashku me hidrokarburet e lëngshme dhe të gazta.

"Hidrokarbure" do të thotë naftë bruto ose gaz natyror.

"Kërkim" do të thotë kërkimi për hidrokarbure me mjete gjeologjike, gjeofizike e të

tjera, dhe përfshin shpimin e puseve të kërkimit dhe vlerësimit.

"Kontraktor" do të thotë çdo person apo persona me të cilët Ministria hyn në Marrëveshje Hidrokarburesh, dhe mund të përfshijë edhe Albpetrolin apo çdo agjenci tjetër shtetërore.

"Ministri do të thotë ajo ministri që drejton veprimtarinë"

"Marrëveshje Hidrokarburesh" do të thotë një marrëveshje e lidhur nga Ministria në përputhje me paragrafin I të nenit 5 të këtij ligji, që autorizon Kontraktorin të kryejë operacione në Zonën e Kontratës dhe mund të marrë formën e një Marrëveshjeje me Ndarje Prodhimi ose ndonjë formë tjetër të rënë dakord mes Ministrisë dhe Kontraktorit e cila nuk është në kundërshtim me këtë ligj.

"Marrëveshje me Ndarje Prodhimi" do të thotë një Marrëveshje Hidrokarburesh, e cila parashikon mbulimin e Kostove të Kontratës nga Hidrokarburet e prodhuara në Zonën e Kontratës ose nga pjesë proporcionale të saj dhe ndarjen midis Shtetit dhe Kontraktorit të sasisë të hidrokarbureve të mbetura pas mbulimit të Kostove të Kontratës në përputhje me një shkallë ose formulë të përcaktuar në Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

"Marrëveshja "Albpetrol"" do të thotë marrëveshja e lidhur më 26 korrik 1993 ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "Albpetrol", me të gjitha ndryshimet e saj, dhe që do të vazhdojë të mbajë karakteristikat e një marrëveshjeje hidrokarbure të llojit të veçantë. Si rrjedhojë, ndarja e prodhimit, e parashikuar në marrëveshjet hidrokarbure, të lidhura ndërmjet shoqërisë "Albpetrol" dhe shoqërive të treta të kërkimit, prodhimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit, do të vazhdojë të kryhet ndërmjet shoqërisë "Albpetrol" dhe shoqërisë përkatëse, në respektim të parashikimeve të këtyre marrëveshjeve."

"Naftë Bruto" do të thotë naftë, asfalte, ozokerite, dhe gjithë llojet e hidrokarbureve dhe bitumeve, të ngurta dhe të lëngta, në gjendjen e tyre natyrore ose të fituara nga gazi natyror nëpërmjet kondesimit apo nxjerrjes, por nuk përfshin qymyrguri apo ndonjë substancë tjetër që mund të nxirret nga qymyrguri.

"Operacione Hidrokarbure" do të thotë të gjithë ose çdo operacion që lidhet me kërkimin, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen dhe përpunimin, grumbullimin, transportimin dhe shitjen ose disponimin e Hidrokarbureve deri në pikën e eksportit ose në një pikë livrimi në Shqipëri për të cilën është rënë dakord ose në pikën e hyrjes në një rafineri, dhe përfshin operacionet e përpunimit të gazit natyror, por nuk përfshin operacionet e rafinimit të hidrokarbureve.

"Plan zhvillimi" do të thotë një plan për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve të zbuluar në një zonë kontrate, I përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 6 të këtij ligji dhe dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Hidrokarbureve për këtë zonë kontrate.

"Praktika të mira të vendburimeve të naftës" do të thotë të gjitha ato praktika që pranohen përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të naftës si të mira, të sigurta,

ekonomike dhe efikase në kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve.

"Person" do të thotë një person fizik a juridik, partneritet, njësi korporate apo ndonjë shoqatë tjetër.

"Prodhim" do të thotë nxjerrja dhe disponimi i hidrokarbureve.

"Rezervuar" do të thotë një grumbullim i veçuar hidrokarburesh.

"Shqipëria" do të thotë Republika e Shqipërisë.

"Zbulim" do të thotë një zbulim i hidrokarbureve i hasur në pusin e parë të çpuar në një strukturë, që mund të nxirret në sipërfaqe me një debit të matshëm nga njësi matëse konvencionale të testimit të industrisë së hidrokarbureve.

"Zonë Kontrate" do të thotë zona brenda së cilës Kontraktori autorizohet të kërkojë, zhvillojë dhe prodhojë hidrokarbure nën një Marrëveshje Hidrokarburesh.

"Zhvillim" do të thotë ndërtimi dhe instalimi i pajisjeve për prodhimin e Hidrokarbureve dhe shpimi i puseve të shfrytëzimit.

""E drejta e ofertës së parë" do të thotë e drejta e shoqërisë "Albpetrol" për të vazhduar operacionet hidrokarbure në zonat ku veprojnë shoqëritë e treta, me të cilat shoqëria "Albpetrol" ka lidhur marrëveshje hidrokarbure, nëse në këto zona marrëveshjet përfundojnë përpara afatit të parashikuar në këto të fundit. Termat dhe kushtet e këtyre marrëveshjeve hidrokarbure do të mbeten të pandryshuara."

Neni 3

Pronësia mbi Hidrokarburet

Të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse dhe të gjitha këto burime do të përdoren për dobinë e popullit shqiptar.

Neni 4

Operacione Hidrokarburesh

Në përputhje me nenin 12.(2) dhe përveç rasteve të operacioneve të vlerësimit të objektit të kryera nën dhe në përputhje me një leje për vlerësim objekti të lëshuar në përputhje me nenin 8, asnjë person nuk do të kërkojë, zhvillojë apo prodhojë hidrokarbure në Shqipëri pa qenë i autorizuar nga Ministria për ta bërë këtë sipas termave dhe kushteve të një Marrëveshjeje Hidrokarburesh.

"Kërkimi, zbulimi, shfrytëzimi i hidrokarbureve dhe operacione të tjera, të përcaktuara në këtë ligj, bëhen vetëm nga subjektet, me të cilat lidhen marrëveshje hidrokarbure, që përfshihen në kategorinë IV.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto marrëveshje lidhen, në përputhje me dispozitat në vijim, të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre marrëveshjeve."

Neni 5 Marrëveshje Hidrokarburesh

(1) Ministria mundet, duke ju nënshtruar paragrafit (2) të këtij neni, të hyjë në Marrëveshje Hidrokarburesh me çdo Person, duke autorizuar atë Person sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të kërkojë, zhvillojë dhe prodhojë hidrokarbure në Zonën e Kontratës.

(2) Ministria nuk do të lidhë Marrëveshje Hidrokarburesh me asnjë Person në qoftë se Ministria nuk bindet se Personi me të cilin do të lidhet Marrëveshja e Hidrokarbureve ka ose mund të sigurojë burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit nën Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

(3) Një Marrëveshje Hidrokarbure mund :

(a) Ti japë një Kontraktori sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të :

(1) Të drejtën ekskluzive për të kryer kërkimin brenda Zonës së Kontratës për një periudhë e cila përveç ndonjë kohe shtesë të kërkuar për të përfunduar punën e marrë përsipër për të vlerësuar një Zbulim, nuk do të kalojë 5 vjet gjithsej, përveçse kur Kontraktori bind Ministrinë se ekzistojnë kushte specifike të cilat kërkojnë një periudhë më të gjatë, atëherë Kontraktorit mund t'i jepet një periudhë që nuk i kalon 7 vite gjithsej.

(2) Të drejtën ekskluzive për një periudhë që nuk i kalon 25 vjetët, për të zhvilluar dhe prodhuar rezervat e hidrokarbureve në Zonën e Kontratës, në përputhje me kushtet e një Plani Zhvillimi të miratuar nga Ministria, si dhe për të ripërtërirë këtë të drejtë aty dhe në masën që parashikon Marrëveshja e Hidrokarbureve.

(3) Të drejtën për të ndërtuar, shtrirë dhe operuar tubacione në Shqipëri, duke ju nënshtruar kërkesave për të lejuar përdorimin e kapacitetit të tepërt nga palët e treta, në kushte tregtare dhe duke ju nënshtruar kushteve të aplikueshme të çfarëdo traktati në të cilin Shqipëria është palë, për t'i lidhur ato me tubacionet dhe pajisjet e vendeve të tjera.

(b) T'i japë Kontraktorit të drejtën e pronësisë për pjesën e tij të hidrokarbureve të prodhuara në zonën e kontratës në një pikë që specifikohet në Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

(c) I garanton Kontraktorit të drejtën të shesë apo të tregtojë për eksport apo ndonjë gjë tjetër Hidrokarburet për të cilat ai ka marrë pronësinë sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve, përveç rasteve kur i nënshtrohet të drejtës së porosisë në kushte emergjence si dhe çdo detyrimi që përmban Marrëveshja e Hidrokarbureve për të furnizuar ose për të kontribuar në furnizimin e tregut lokal.

(d) Një marrëveshje Hidrokarburesh, në të cilën është palë një investitor i huaj, mund të përmbajë klauzola lidhur me stabilitetin e regjimit fiskal.

(e) Duke iu nënshtruar këtyre masave mbrojtëse dhe rezervimeve siç mund të përfshihen në Marrëveshjen e Hidrokarbureve, kjo Marrëveshje mund t'i njohë Kontraktorit të drejtën :

(1) të marrë dhe të mbajë jashtë vendit të ardhurat e shitjes në monedhë të huaj të hidrokarbureve të cilat i ka marrë në zotërim sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve dhe t'i përdorë këto të ardhura ashtu siç e gjykon të përshtatshme, duke ju nënshtruar pagesës së taksës mbi të ardhurat dhe detyrimet të tjera në Shqipëri.

- (2) të dërgojë jashtë vendit, në monedhë të huaj të konvertueshme, fitimet e arritura nga Kontraktori nga shitja e Hidrokarbureve në Shqipëri.
- (3) të hapë dhe të përdorë llogari të huaja bankare me qëllim që të paguajë për mallra, shërbime dhe personelin e kërkuar për kryerjen e Operacioneve të Hidrokarbureve nën Marrëveshjen e Hidrokarbureve.
- (4) të konvertojë monedhën e huaj në monedhë vendase sipas kursit më të favorshëm të këmbimit në agjencitë e autorizuara, për të përmbushur detyrimet në monedhë vendase që lindin nga operacionet Hidrokarbure.
- (f) Kur një Investitor i Huaj është palë në një Marrëveshje Hidrokarburesh, të vendosen klauzola për zgjidhjen nga arbitrazhi ndërkombëtar të mosmarrëveshjeve që lindin prej ose që lidhen me Marrëveshjen.
- (g) Përfshin klauzola të tjera që mund të duken të nevojshme dhe të dëshirueshme në lidhje me kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure.

Neni 6 Detyrimet e Kontraktorit

Cdo Marrëveshje Hidrokarburesh e lidhur nga Ministria do të përmbajë në një formë të përshtatshme, të rënë dakord midis palëve, angazhime nga Kontraktori:

- (a) për të kryer Operacione Hidrokarburesh në përputhje me këtë ligj, dispozitat ligjore në fuqi "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe në përputhje me Rregulloret e nxjerra prej këtij ligji dhe me praktikat e mira të industrisë së naftës;
- (b) për të raportuar në Ministri zbulimin e Hidrokarbureve në Zonën e Kontratës;
- (c) për të përgatitur dhe për t'i paraqitur Ministrisë për aprovim, në rast të një zbulimi komercial, planin e zhvillimit I cili :
- (1) do të sigurojë përdorimin me efikasitet dhe me dobi të rezervave të Hidrokarbureve të njehsuara nga Kontraktori;
- (2) do të kujdeset siç duhet për ruajtjen e mjedisit dhe mirëqenien e njerëzve që banojnë në zonat ku kryhen Operacionet e Hidrokarbureve sipas marrëveshjes;
- (d) për të zhdëmtuar Shtetin ose Ministrinë ndaj gjithë pretendimeve të palëve të treta në lidhje me plagosjet, humbjet ose dëmtimet që rezultojnë nga ndonjë operacion i kryer nga Kontraktori ose nga ndonjë nënkontraktor;
- (e) për t'i dhënë përparësi punësimit dhe kualifikimit të shtetasve shqiptarë, si dhe mallrave dhe shërbimeve vendase, në përputhje me klauzolat që do të përfshihen në Planin e Zhvillimit, në masën që ato janë kompetitive përsa i përket çmimeve dhe të krahasueshme përsa i përket cilësisë.

Neni 7 Autorizimi për Kontraktorin

Kur një Kontraktor ka lidhur Marrëveshje Hidrokarburesh me Ministrinë, Shteti do t'i japë Kontraktorit ose të sigurojë që Kontraktorit t'i jepen të gjitha lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera të ligjshme të cilat, Kontraktori, mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të mundësuar kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në përputhje me Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

Neni 8

Lejet për vlerësimin e objektit

(l) Ministria mund t'i japë Leje për vlerësim objekti çdo personi, sipas termave dhe kushteve të parashikuara në të, duke autorizuar mbajtësin e Lejes të ndërmarrë kërkim në zonën e lejuar nëpërmjet studimeve ajrore, gjeofizike, gjeokimike, paleontologjike, gjeologjike, topografike, studimeve e vrojttimeve seizmike dhe interpretimit të tyre.

(2) Vetëm në qoftë se nuk është paraqitur ndryshe në Lejen e vlerësimit, kjo leje :

(a) Do të mbarojë në fund të një periudhe prej 2 vjetësh;

(b) Nuk do të jetë ekskluzive;

(c) Nuk do të autorizojë shpimin e puseve të kërkimit

(d) Nuk do t'i njohë mbajtësit të lejes ndonjë të drejtë preference për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarburesh me Ministrinë.

Neni 9

Rregulloret dhe Kontratat Model

(l) Në bazë të këtij ligji, Ministria mund të hartojë rregullore për ose në lidhje me:

(a) Regjistrimin e Kontraktorëve;

(b) Mënyrën në të cilën duhen të paraqiten nga Kontraktori raportet, të dhënat, informacioni dhe llogaritë.

(c) Masat lidhur me ruajtjen e burimeve të hidrokarbureve, sigurinë, shëndetin, mbrojtjen e mjedisit dhe

shmangien e rrjedhjeve, mbetjeve, ndotjes dhe aksidenteve;

(d) Ndarjen e zonave me potencial hidrokarbur në zona apo blloqe me numra ;

(e) Të drejtën e përdorimit të tokave publike dhe private në lidhje me operacionet e hidrokarbureve ;

(f) Çdo çështje tjetër në lidhje me të cilën Ministria e konsideron se duhet të hartohen rregullore për ta bërë të efektshëm këtë ligj.

(2) Ministria herë pas here mund të publikojë Marrëveshje Model Hidrokarburesh.

"3. Në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), kontraktorët që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure, organet e administratës tatimore dhe doganore, si dhe organet e qeverisjes qendrore dhe vendore kanë detyrimin të raportojnë, sipas standardit të caktuar nga kjo Nismë, pranë Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë nxjerrëse, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse publikon të dhënat sipas standardit EITI."

Neni 10

E drejta e Përdorimit të tokës

(l) Në bazë të kushteve të specifikuara në rregulloret e hartuara në përputhje me nenin 9.l(e), do të gjykohet që një Kontraktori i është dhënë, sipas dispozitave të ligjit "Për Tokën", e drejta për të hyrë dhe përdorur tokë publike ose private për të kryer Operacione Hidrokarburesh nën Marrëveshjen e Hidrokarbureve ku Kontraktori është palë.

(2) Nëse Kontraktori nuk paguan kompensim kur i kërkohet, ai do t'i nënshtrohet gjobave të specifikuara në rregulloret përkatëse.

(3) Për qëllimet e këtij neni "tokë private" do të thotë tokë në pronësi private dhe tokë e dhënë me qera apo në përdorim nga Shteti.

Neni II Njësimi

Kur një rezervuar hidrokarburesh ndodhet pjesërisht në një Zonë Kontrate dhe pjesërisht në një Zonë tjetër Kontrate dhe kur Ministrisë i duket se mund të arrihet rritje e efektivitetit përmes zhvillimit dhe operimit të përbashkët në atë rezervuar, Ministria do të ketë të drejtën t'i urdhërojë kontraktorët të zhvillojnë dhe operojnë së bashku rezervuarin sipas një marrëveshje të lidhur prej tyre për këtë qëllim.

Neni 12 Klauzola tranzitore dhe Përfundime.

1) Për sa i përket marrëveshjeve të përshkruara në shtojcën bashkëlidhur këtij Ligji (marrëveshjet për detin), nga data në të cilën ky Ligj hyn në fuqi:

a) Çdo njëra nga këto marrëveshje do të konsiderohet se është lidhur në mënyrë të ligjshme nga Ministria sipas nenit 5 të këtij ligji dhe sipas paragrafit 12.(I) do të vazhdojë të jetë e vlefshme dhe e detyrueshme në përputhje me kushtet e saj.

b) Çdo njëra nga këto marrëveshje konsiderohet që referencat ndaj DPNG (këtu dhe më poshtë do të kuptohet si

Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe e Gazit) ose ndaj ndonjë pasuesi të të drejtave të DPNG, i referohen Ministrisë.

c) Pa pasur parasysh interesat e pjesëmarrjes që këtej e tutje mund të merren nga ndonjë pasardhës i të drejtave të DPNG, sipas marrëveshjeve midis Kontraktorit dhe Ministrisë, DPNG dhe pasuesit e saj në pronësi nuk do të jenë palë ose nuk do të kenë ndonjë të drejtë, pronësi ose interes në asnjërën nga këto marrëveshje.

2) Përsa i përket zonave ku Albpetroli është duke kryer operacione kërkimi, zhvillimi dhe shfrytëzimi të hidrokarbureve do të konsiderohet se Ministria ka hyrë në Marrëveshje me Albpetrolin, duke e autorizuar atë të kryejë këto operacione në përputhje me këtë Marrëveshje.

"Në lidhje me marrëveshjen e mësipërme, që do të quhet "Marrëveshja Albpetrol":

a) Marrëveshja Albpetrol do të jetë e vlefshme dhe e detyrueshme në përputhje me termat e saj dhe Ministria i jep leje (licencë) Albpetrolit siç përmendet atje (në marrëveshje). Një leje (licencë) do ta autorizojë Albpetrolin, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të, për të kërkuar, zhvilluar dhe prodhuar hidrokarbure në zonën e kontratës dhe, në të kundërt, të vazhdojë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës. Të gjitha dispozitat e këtij ligji, të zbatuara në ose në lidhje me Marrëveshjen Hidrokarbure, do të zbatohen në dhe në lidhje me një leje (licencë), e cila do të ketë fuqi si kontratë.

b) Pa paragjykuar karakterin e përgjithshëm të paragrafit

(a) të mësipërm, një leje (licencë) mund ta lejojë Albpetrolin, me pëlqimin e Ministrisë, të transferojë dhe të kalojë të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave, titullimit dhe interesit të tij në të një personi juridik, vendas a të huaj, ose institucionit ndërkombëtar financiar, me të cilin ai dëshiron të bashkëpunojë për qëllimet e përmendura në Marrëveshjen Albpetrol.

c) Marrëveshja Albpetrol autorizon Albpetrolin të hyjë në Marrëveshje Hidrokarbure, duke autorizuar personin ose

institucionin përkatës, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të, të kërkojë,

zhvillojë e prodhojë hidrokarbure në zonën e kontratës dhe, në të kundërt, të vazhdojë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës. Një marrëveshje e tillë Hidrokarbure, e cila nuk do të bjerë në kundërshtim me termat e lejes (licencës) përkatëse, do të jetë Marrëveshja Hidrokarbure e lidhur sipas këtij ligji"

"ç) "Marrëveshja Albpetrol" lejon Albpetrolin ("Albpetrol" sh.a.), të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet. Ministria, që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregtimit të hidrokarbureve për këtë qëllim."

"3. Marrëveshja "Albpetrol", e lidhur më 26 korrik 1993, me të gjitha ndryshimet e saj dhe listat e objekteve të operacioneve hidrokarbure, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, do të qëndrojë në fuqi edhe pas përfundimit të procesit të privatizimit. Marrëveshja "Albpetrol" është një marrëveshje hidrokarbure e veçantë, ku të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje do të vazhdojnë të zbatohen mbi zonat e parashikuara në listat A, B dhe C.

Për zonat ku shoqëria "Albpetrol", sh. a., kryen operacione e vetme, për të cilat nuk janë lidhur marrëveshje hidrokarbure me shoqëri të treta, shoqëria "Albpetrol", sh.a., ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure kërkimi, zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi të naftës e të gazit për një afat 25-vjeçar, i cili do të fillojë pas datës efektive të kontratës së blerjes së aksioneve të shoqërisë "Albpetrol", sh.a., nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë hidrokarbure. Termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje hidrokarbure përcaktohen si shtojcë në marrëveshjen "Albpetrol". Për sa i përket zonave të parashikuara në listën C, afatet e operacioneve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin rregullohen në marrëveshjet hidrokarbure."

"3. Marrëveshja "Albpetrol", e lidhur më 26 korrik 1993, me të gjitha ndryshimet e saj dhe listat e objekteve të operacioneve hidrokarbure, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, do të qëndrojë në fuqi edhe pas përfundimit të procesit të privatizimit. Marrëveshja "Albpetrol" është një marrëveshje hidrokarbure e veçantë, ku të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje do të vazhdojnë të zbatohen mbi zonat e parashikuara në listat A, B dhe C.

Për zonat ku shoqëria "Albpetrol", sh. a., kryen operacione e vetme, për të cilat nuk janë lidhur marrëveshje hidrokarbure me shoqëri të treta, shoqëria "Albpetrol", sh.a., ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure kërkimi, zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi të naftës e të gazit për një afat 25-vjeçar, i cili do të fillojë pas datës efektive të kontratës së blerjes së aksioneve të shoqërisë "Albpetrol", sh.a., nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë hidrokarbure. Termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje hidrokarbure përcaktohen si shtojcë në marrëveshjen "Albpetrol". Për sa i përket zonave të parashikuara në listën C, afatet e operacioneve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin rregullohen në marrëveshjet hidrokarbure."

Neni 13

Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes Hidrokarbure.

1) Një marrëveshje hidrokarburesh, në zbatim të nenit 5 të këtij ligji, do të

nënshkruhet nga "Ministri" që drejton veprimtarinë" ose nga një person i autorizuar me shkrim prej tij.

2) Një marrëveshje hidrokarburesh hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin e Ministrave.

Neni 14

Të gjitha dispozitat ligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.625, datë 4.8.1993 , të Presidentit të Republikës së Shqipërisë , Sali Berisha.

SHTOJCE

1) Marrëveshja "Për kërkimin zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-së dhe Deminex Albanian Petroleum GMBH e OMV, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.152, datë 20.4.1991.

2) Marrëveshja "Për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-së dhe Chevron International (Albania) zlimited, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.334 , datë 10.9.1991.

3) Marrëveshja "Për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-së dhe Occidental of Albania Inc.,me vendim të Këshillit të Ministrave nr.360, datë 21.9.1991.

4) Marrëveshja "Për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-së dhe AGIP (overseas) limited, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.376, datë 11.10.1991.

5) Marrëveshja "Për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", midis DPNG-së dhe Hamilton Oil (Albania), me vendim të Këshillit të Ministrave nr.476, datë 23.12.1991.

"Marrëveshja për autorizimin e kryerjes së operacioneve hidrokarbure, e lidhur më 26 korrik 1993 ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike (sot Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike) dhe Albpetrolit (Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit)".